



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Mora } 31.10.2016
Dofa } Prot 877

Nr. 2297 Prot.

Tiranë, më 28.10.2016

Lënda: Lidhur me procesin e provimit të shtetit në profesionin e mësuesit

Drejtuar: ZA KAMEZ

Për dijëni: **MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**

TIRANË

Gjatë sezonit të kaluar të provimeve të shtetit Korrik 2016, nga AKP janë konstatuar disa raste të kandidatëve pjesëmarrës për provim shteti në mësuesi, dokumentet e të cilëve kanë rezultuar të parregullta. Konkretisht, një pjesë e kandidatëve të cilët nuk ishin pajisur me diplomën e ciklit të dytë të studimit por me vërtetim të përfundimit të studimeve nga IAL-të përkatëse, kanë paraqitur edhe certifikatën TOEFL të njohjes së gjuhës së huaj angleze. Këto certifikata kanë rezultuar të lëshuara nga shoqata "Ader" dhe jo nga **organizata ndërkombëtare ETS**, e cila ka tagrin ekskluziv për të zhvilluar testin TOEFL për nivelin e njohjes së gjuhës së huaj angleze.

Lidhur me sa më sipër, lutemi të verifikoni me kujdes dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që do të regjistrohen në provim shteti për mësuesi. Theksojmë se kandidatët për t'u regjistruar në këtë provim shteti, mbështetur në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, neni 7, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenin 4 pika 6 të Rregullores, "Për organizimin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 82, datë 22.02.2011, e ndryshuar, **duhet të jenë të pajisur me diplomat e ciklit të parë dhe të dytë të studimit, të lëshuar nga IAL-të përkatëse.** Neni 7 i ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 thekson sa më poshtë:

Neni 7

Formimi dhe kualifikimi profesional për ushtrimin e profesionit të rregulluar

Personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

AKP-ja nuk do të mundësojë kandidatët të cilëve u mungojnë këto dokumente, të marrin pjesë në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Kjo kërkesë e mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi bëhet në kuadër të përgjegjshmërisë së AKP për të pajisur studentët të cilët realisht i kanë përfunduar të gjitha detyrimet ligjore të programeve të studimit, me licencat përkatëse.

Faleminderit për mirëkuptimin,

DREJTORE E PËRGJITHSHME


Rezana VRAPI

